




POP 5


Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit




në Lezhë! Ardi Veliu dhe SHÇBA nisnin hetimet (VIDEO)



Nesër vendimi për Fatmira Hajdarin, si u zbulua ndalimi për të hyrë në Amerikë. Vetingu i la 72 orë afat për të justifikuar 470 mijë USD



Blau fahesë 3.3 mijë €, anulohet vetingu për Shpresa Beçajn, pasuria ekskluzive me vlerë 600 mijë \$, vajza e tyre mbi 300 mijë € apartamente e makina



Momente nga shoqërimi i gazetarit të Report TV, kush është polici që 'bën të fortin' me ata që bëjnë punën e tyre


SHCOM

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Aktualitet

Tiranë, shpërthim me eksploziv në një lokal pranë gjimnazit "Petro Nini", ngjarja është filmuar nga kamerat e sigurisë (VIDEO)

Një shpërthim me lëndë plasëse ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të kësaj të enjteje në Tiranë.Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:30 në një lokal në rrugën "Dëshmorët e 4 shkurtit"



Redaksia

11 Qershor, 07:21 | Përditësimi i fundit: 11 Qershor, 12:47

Share 36

Tweet

Kryeqyteti është tronditur mëngjesin e sotëm nga një shpërthim me eksploziv. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:30 në një lokal pranë shkollës "Petro Nini", në rrugën "Dëshmorët e 4 shkurtit" në pronësi të shtetasit Arben Koçollari.

Shpërthimi ka alarmuar banorët, pasi zona është një nga më të frekuentuarat, por për fat të mirë nuk raportohet për asnjë person të lënduar, por vetëm dëme materiale.

SHCOM

LEXO EDHE: Tiranë/ Dy aksidente në mëngjes, mjetet përplasnin 2 vajza që udhëtonin me biçikletë, autorët largohen nga vendngjarja

Nga burimet mësohet se në lokal ishte vendosur një sasi prej 100 gram tritolit, të vendosur në pjesën përpara lokalit.

Pronari i lokalit është pa precedent penal dhe dyshohet se lënda plasëse i është vendosur për arsye konkurrence. Mësohet se para oficerëve të policisë, ai ka deklaruar se nuk ka konflikte.

Grupi hetimor ka mbledhur të gjithë pamjet filmike të kamerave të sigurisë, që mund të ndihmojnë në identifikimin dhe kapjen e autorit.

Sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, lokali "JuJo" në pronësi të Arben Koçollarit është regjistruar në vitin 2018.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIIS)	L82110014A
2. Emri i subjektit	Arben Koçollari
3. Forma ligjore	Person Fizik
4. Data e regjistrimit	10/09/2018
5. Fusha e veprimtarisë	Bar kafe
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit	Tiranë Tiranë, TIRANË Rruga Sami Frasheri, Pallati 22, Shk. 3, Kat 1
7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
8. Të dhëna që njohohen gjallëtarisht	Emri Tregtar: JuJo Coffee & Snack E-Mail: egjinollari@diaconsulting.al Telefon: 0696591870
9. Statusi	Aktiv

Date: 11/06/2020

Emri, Muesimi, Nënshkrimi
(i nëpunësit të portelait)

Përveç lokalit, në të cilin ishte vendosur lënda plasëse, dëme ka pasur edhe në një dyqan lulesh, që është ngjitur me lokalin.

Grupi hetimor dhe shërbimet e Policisë shkruan në vendngjarje dhe vijon puna për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit.

Shpërthim me eksploziv lokalit pranë gjimnazit "Petro Nini", ka...

Share 35

Tiranë, shpërthim me tritol në një lokal pranë gjimnazit Petro Nini Luarasi (FOTO)

Share 0

m.x./b.ha./Shqiptarja.com

TAG: tirane shperthim tritol lokal Arben Koçollari

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SHCOM

Sondazhi i ditës:

Rritja alarmante e të infektuarve me COVID, a duhet të izolohehi sërish?

Po

Jo

Izolim i pjesshëm

Komento

Iris:

11/06/2020 22:26

/BANOR/edhe une jam dakort me opinionin tuaj per emertimet e rugeve.Jam lindur e rritur ne Tirane e tani jetoj jashte por kam probleme me adresen postare,bile dhe te shtepise time.Jo cdo document dergohet on-line,disa duhen me vule apostile qe kushton goxha kur ti pergatisin zyrat perkatese,dhe ne fund kur I dergon ti humb posta.Mua njerin ma kthyen me pretendimin idiot se adresa nuk gjendet(kam derguar me emertimin e ri e te vjetrin)kurse nje te dyle qe e dergova ne Durres u zhduk si kripa ne uje.Kjo me sa kuptoj eshte problem per qytetet e medha ,te voglat jane me mire.E pa besueshme qe ne shek.XXI t'a dergojme posten dorazi me te njohur sikur jemi ne mesjetet!

Përgjigju

Banor:

11/06/2020 10:55

Me sa dihet kjo rruge quhet Sami Frasher, kuse Deshmoret e 4 Shkurtit eshte rruga para Carlsbergut, qe te con te garda. Rruge rrumpalle, qe asnjehere nuk u emertuan sic duhet. Kush merr bashkine, nderron emrat e rugeve..... Po te shofesh kush eshte punesuar ne bashki , tmerrohes!

Përgjigju

Gjeco:

11/06/2020 20:58

Dmth duhet të jesh fshatar!

Gjecolino:

11/06/2020 16:05

Jo Gjeco, nuk i donte trapi fare me u marr me suflaqexhinj si puna jote, thjesht eshte banor i zones.

Gjeco:

11/06/2020 11:25

Dmth ti do të doje të punoje ne bashki por nuk ja arrite dot sepse s ke nivel!

Pyetje:

11/06/2020 08:52

Nuk thom qe gabime nuk ndodhin,po zakonisht se hjedh kush dinamit kot. Kjo eshte ba me plan e ka kosto se ka rezik. A thua mos je perzie me noj Kurbinas o Fushe Krujas?

Përgjigju

Populli:

11/06/2020 08:38

U rikthye 1997-ta

Përgjigju

Kafsha:

11/06/2020 08:32

Aktiviteti kryesor i shqiptarit , lokalit! Jeta e shqiptarit ne lokal, shperthim ne lokal, vrasje ne lokal etj etj... lokal dhe vetem lokal! Kafe, pilaf, fasule, raki... lokal dhe vetem lokal! Lokal poshte pallatit, lokal ne fshat, u kthye ne banese nga lokali, po shkonte nga banesa ne lokal, u dhj-e ne lokal, lokal, lokal, lokal, lokal!

Përgjigju

Kafsha:

11/06/2020 11:01

Nuk eshte problemi tek raca por tek tranzicioni i rëndë politiko-ekonomiko-social qe Shqiperia vuan për 30 vjet. Xhaxhi Enver e beri shqiptarin të lulezoje me fabrika e uzina. Bëri rend shembi dha atij thjeshtesi e lumturi. Pra nuk eshte problemi i races.

Bina:

11/06/2020 09:33

Fiks fare u dhjefsa lokalet.....!

gjethja e thete e fikut:

11/06/2020 09:28

Te falenderoj per kete esee, shqiptari do ishte mire qe edhe pas vdekje te varrosetj ne lokal, lokalin shqiptari e ka si femijen e tij, race albanistani.

Lajme të tjera

Pas Policisë së Shteti, edhe SHÇBA nis hetimet për rastin e shoqërimit të gazetarit të Report Tv, Elvis Hila

17 Qershor, 21:51

Momenti i përplasjes së pronarës me policinë, që po filmonte gazetari i Report Tv para se të shoqërohej

17 Qershor, 21:42

Momente nga shoqërimi i gazetarit të Report TV, kush është polici që 'bën të fortin' me ata që bëjnë punën e tyre

17 Qershor, 21:35

Shoqërimi i gazetarit të Report Tv nga policia, Ardi Veliu nis hetimet

17 Qershor, 21:23

Sherr për vijën e ujit, vritet me sende të forta 60-vjeçari në Gjirokastër

17 Qershor, 21:19

Shoqërohet gazetari i Report TV, arroganca e shefit të rendit Agron Qullhaje: Nuk të jap llogari, po bëj detyrën

17 Qershor, 21:16

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndaloheh riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje